


REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. DPK Nr. Prot. 03-02/1007/16
 Dep. DPK Broj Prot. 03-02/1007/16
 Nr. Ftaq. 02 Dat. 08.03.2016
 Broj stranica 02 Dat. 08.03.2016
 Nr. pages 02 Dat. 08.03.2016



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	08.03.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-02-964/16
PËR/ZA/TO:	znj. Fitore Gashi – Asistente Ekzekutive në Agjencinë për Barazi Gjinore
CC:	znj. Edona Hajrullahu – Kryeshefe Ekzekutive e Agjencisë për Barazi Gjinore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik

E nderuara znj. Gashi,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 dhe 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, lidhur me kërkesën që keni bërë për znj. Edona Hajrullahu për konstituimin e një biznesi privat, ju njoftojmë se,

Çështja e konstituimit të bizneseve private është e rregulluar me Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në tekstin e mëtejshëm Ligji PKI).

Në bazë të këtij ligji zyrtari i lartë publik mund të jetë pronar në kompani private mirëpo nuk mund të ushtroj të drejtën e pronësisë në mënyrë aktive (neni 16, pika 3).

Kjo nënkupton se zyrtari i lartë mund të jetë vetëm pronar pasiv në biznese private. Të qenurit pronar pasiv nënkupton se ai ruan të drejtën e përfitimit të fryteve të pronësisë, por nuk mund të

ushtroj vet asnjë veprim tjetër mbi këtë pronë. Të gjitha veprimet tjera si administrimi, zotërimi, kryhen nga personi i besuar nga pronari (neni 3, pika 1.7.)

Andaj, për të qenë pronar pasiv, duhet të barten të drejtat e administrimit ose menaxhimit të biznesit tek një person i besuar (jo i afërt familjar), i cili do të veprojë në drejtim të realizimit të drejtave të zyrtarit të lartë dhe të drejtave nga kapitali në emër të tij por për llogari të zyrtarit të lartë.

Gjatë kohës derisa të drejtat për administrim me ndërmarrjen i janë transferuar personit të besuar, zyrtari i lartë nuk ka të drejtë të jap informata, udhëzime, urdhëresa apo në ndonjë mënyrë tjetër të qëndroj në lidhje me personin e besuar ashtu që të ketë ndikim në realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrave që dalin nga të drejtat e anëtarëve të ndërmarrjeve të tilla.

Zyrtari i lartë ka të drejtë të informohet për ecuritë dhe gjendjen në ndërmarrjen ku ka pronësi, ose pjesë të pronësisë (neni 14, Ligji PKI).

Ndërsa lidhur me pyetjet nga deklarimi i pasurisë, ju njoftojmë se zyrtari i lartë duhet të deklaroj pasurinë duke përfshirë edhe bizneset private (pronar, bashkëpronar). Gjithashtu në formularin e deklarimit të pasurisë duhet të deklarohen edhe gjitha funksionet/pozitat tjera, si dhe duhet të deklarohen të ardhurat nga ai biznes apo funksione.

Andaj, konform asaj që u tha më lartë, iu rekomandojmë që të ndërmerrni të gjitha masat konform këtij opinioni, që të parandaloni konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia u është mirënjohës për bashkëpunimin tuaj dhe ju inkurajon që të vazhdoni këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Me respekt!